VENDIM
Nr. 17, datë 13.3.2014

MBI SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E "NJOFTIMIT TË FAZËS SË REZERVIMIT/*BOOKING PHASE NOTICE"* PARAQITUR NGA TAP AG PËR PROCEDURËN E ALOKIMIT TË KAPACITETEVE TË GAZSJELLËSIT TAP NË PËRPUTHJE ME UDHËZUESIN E APROVUAR ME VENDIMIN NR. 16, DATË 13.3.2014

Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.3.2014,
Në zbatim të:
- Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim: direktiva 73/09);
- Rregullores 713/2009/ EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009;
- Rregullores 715/2009/ EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009;
- Ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar;
- Vendimit nr. 39, datë 23.4.2012 "Për miratimin e udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin Trans Adriatic Pipeline (TAP) sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC";
- Vendimit nr. 79, datë 15.6.2012 "Për miratimin e dokumentit "Ftesë për shprehje interesi"", të shpallur nga TAP AG në përputhje me udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit Trans Adriatic Pipeline (TAP sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC;
- Vendimit nr. 27, datë 1.3.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline";
- Vendimit të Komisionit Europian C (2013) 2949 të datës 16 maj 2013 "*Exemption of Trans Adriatic Pipeline from the requirements on third party access, tariff regulation and ownership unbundling laid down in Articles 9, 32, 41(6), 41(8) and 41(10) of Directive 2009/73/EC"*;
- Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) të datës 14 maj 2013;
- Vendimit nr. 64, datë 13.6.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s" nr. 27 datë 1.3.2013 "Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline", për marrjen në konsiderate të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Europian (C(2013)2949" nëpërmjet miratimit të dokumentit "Opinion i Përbashkët Përfundimtar i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtim. Autoriteti për Energjinë Elektrike, Gazin dhe Sistemet Ujore (Itali), Enti Rregullator i Energjisë (Shqipëri) dhe Autoriteti Rregullator i Greqisë (Greqi)"/ "*Final Joint Opinion of the Energy Regulators on TAP AG's Exemption Application Autorita per l'Energia Elettrica e il Gas (Italy)*, Enti Rregullator i Energjisë (Albania) and *Regulatory Authority of Greece (Greece)*" në vijim *Final Joint Opinion*;
- Vendimit nr. 127, datë 7.11.2013 "Mbi miratimin e metodologjisë së tarifave" (*TAP Tariff Code*), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në "Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*" në kuadër të procedurës për përjashtimin e gazsjellësit TAP;
- Vendimit nr. 12, datë 14.2.2014 "Mbi shqyrtimin dhe miratimin e "Programit të përputhshmërisë rregullatore/*Regulatory Compliance Programme*" paraqitur nga TAP AG në bazë të "Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*" në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP.
- Vendimit nr. 16, datë 13.3.2014 "Mbi miratimin e "Udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin Trans Adriatic Pipeline (TAP) për fazën e parë të rezervimit (*First Booking Phase*) sipas Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion* në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP";
- Kërkesës së dorëzuar nga TAP AG nr. 272/1, datë 12.3.2014 për aprovimin e "Njoftimit të fazës së rezervimit/*Booking Phase Notice*", i cili përmban rregullat dhe procedurat për pjesëmarrje në fazën e parë të rezervimit/*First Booking Phase*.
Duke konsideruar që:
- Shoqëria TAP AG ka paraqitur në ERE, në përputhje me ligjin nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, kërkesën për përjashtim në lidhje me projektin e një interkonjektori që kalon nga Greqia, dhe Shqipëria për të vijuar në Itali (në vijim gazsjellësi TAP) dhe si të tillë për efekt të përjashtimit është e

nevojshme përfshirja edhe e autoriteteve rregullatore (në vijim autoritetet) për Greqinë, Enti Rregullator i Energjisë (në vijim RAE) dhe për Italinë, Autoriteti për Energjinë Gazin dhe Sistemet Ujore (në vijim AEEGSI);
- Neni 36, paragrafi 6, i direktivës 73/09 parashikon që autoriteti rregullator, para se të lejojë një përjashtim, duhet të miratojë rregulla dhe mekanizma:
i) Për alokimin e kapacitetit, të cilat kërkojnë që të ftohen të gjithë përdoruesit e mundshëm të infrastrukturës për të shprehur interesin e tyre për përdorimin e kapacitetit përpara se të jetë kryer alokimi i këtij kapaciteti në infrastrukturën e re, përfshirë edhe për vetëpërdorim (këtu e në vazhdim: testimi i tregut).
ii) Për menaxhimin e kapaciteteve, të cilat përfshijnë të drejtën e zotëruesit për të shitur kapacitetet e papërdorura në tregun dytësor dhe detyrimin për të ofruar kapacitetin e papërdorur në treg në rast të "kufizimit kontraktual";
- Dispozita e mësipërme, gjithashtu, kërkon që në vlerësimin e kritereve për dhënien përjashtimit të kërkuar, autoritetet rregullatore duhet të marrin parasysh rezultatet e procedurës së alokimit të kapaciteteve;
- Në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura, është zhvilluar një fazë e parë jodetyruese e testimit të tregut (faza e shprehjes së interesit/*Expression of Interest Phase*), në të cilën të gjithë përdoruesit e mundshëm të gazsjellësit TAP ishin të ftuar për të shprehur interesin e tyre për përdorimin e kapacitetit të kësaj infrastrukture, si në lidhje me kapacitetin e ofruar nga TAP, ashtu edhe me propozimet për lloje të ndryshme të produkteve të ofruara.
- Në përfundim të fazës së parë të testimit të tregut (faza e shprehjes së interesit/*Expression of Interest Phase*), pasi ERE i cilësoi të plotësuara kushtet e nenit 36 pika 6 të direktivës 73/09, me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*, ka shprehur mendim pozitiv për çështjen e vendimit formal për përjashtimin në favor të kompanisë TAP AG;
- I sipërcituari Opinioni i Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion* parashikon edhe një fazë të dytë të testimit të tregut, në të cilin pjesëmarrësit e fazës së parë janë të ftuar të dorëzojnë kërkesat për rezervimin e kapacitetit të tubacionit (TAP "*Booking Phase*");
- Në zbatim të ekzekutimit të fazës së parë të rezervimit*/First Booking Phase*, të planifikuar për 17 mars 2014, ERE ka përgatitur së bashku me RAE dhe AEEGSI "Udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit Trans Adriatic Pipeline (TAP) në përputhje me paragrafin 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC-faza e dytë: ftesa për palët e interesuara të dorëzojnë kërkesa rezervimi detyruese për produktet e kapacitetit/*Guidelines for management and allocation of capacity of the Trans Adriatic Pipeline (TAP) project according to paragraph 6 of Article 36 of the Directive 2009/73/EC –Phase II: invitation to interested Parties to submit binding booking request for capacity products"* (këtu e në vazhdim: *the Giudelines*), të miratuar në vendimin nr. 16, datë 13.3. 2014, që nga ana e tij ka për qëllim të përcaktojë parimet e përgjithshme të cilave TAP AG duhet t'i përmbahet për hartimin e procedurës për pjesëmarrje në fazën e rezervimit/*Booking Phase* dhe për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të gazsjellësit qe janë disponibël;
- Në lidhje me pikën e mësipërme, ky udhëzues parashikon, në veçanti, që TAP AG të hartojë rregullat e sipërpërmendura të procedurës në njoftimin për fazën e rezervimit/*Booking Phase Notice*, e cila do t'i nënshtrohet aprovimit të përbashkët të rregullatorëve.
- Rregullat e sipërpërmendura të procedurës kanë qenë objekt i një bashkëpunimi të frytshëm midis TAP AG dhe autoriteteve rregullatore të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë me qellim hartimin e tyre në përputhje me udhëzuesin e hartuar nga këto autoritete.
- Së fundmi, në datën 12 mars 2014, shoqëria TAP AG i ka paraqitur një propozim të "Njoftimit për fazën e rezervimit/*Booking Phase Notice*", ERE-s, si edhe autoriteteve RAE dhe AEEGSI, në mënyrë që të marrë miratimin e tyre.
Duke marrë parasysh që:
- "Njoftimi për fazën e rezervimit/*Booking Phase Notice*" është në përputhje me udhëzuesin/*Guidelines*, të miratuar me vendimin nr. 16, datë 13.3.2014.
- I njëjti opinion ndahet edhe nga RAE dhe AEEGSI.
- Është e nevojshme të miratohet skema e propozuar nga "Njoftimi për fazën e prenotimit/*Booking Phase Notice*", bashkëngjitur me këtë dispozitë, në mënyrë që të vijojë ekzekutimi i fazës së parë të rezervimit/*First Booking Phase*.

VENDOSI:

1. Të miratojë "Njoftimin e fazës së rezervimit/*Booking Phase Notice*" të propozuar nga TAP AG në datën 12.3.2014, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Njoftimin e autoriteteve rregullatore të energjisë të Italisë (AEEGSI) dhe Greqisë (RAE) dhe TAP AG, për

marrjen e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti